



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale

Nr. 160/5 Prot.

Tiranë, më 30/5/2014

REKOMANDIM

Nr 55, datë 30/5/2014

Mbështetur në ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr 211, datë 11.09.2008 "Për zgjedhjen e Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" dhe nr. 225, datë 13.11.2008 "Për miratimin e strukturës organike dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale", pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Hetim-Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit "Agjencia Kombëtare e Provimeve" (AKP), Tiranë.

KONSTATOVA

Në zbatim të Urdhrit nr. 24 datë 05.02.2014 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, është kryer kontrolli administrativ pranë kontrolluesit "Agjencia Kombëtare e Provimeve" me objekt: "Zbatimi nga ana e kontrolluesit "Agjencia Kombëtare e Provimeve" i ligjit nr. 9887 datë 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, si dhe akteve të miratuara nga Komisioneri, gjatë kryerjes së aktivitetit të tij në fushën e organizimit të provimeve kombëtare në sistemin parauniversitar, pranimeve në universitete dhe provimeve të shtetit për profesionet e rregulluara".

"Agjencia Kombëtare e Provimeve" në kuptim të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, është kontrollues publik, i cili gjatë veprimtarisë së tij mbledh, përpunon dhe ruan të dhëna personale me qëllim përmbushjen e detyrave ligjore. Të dhënat personale mbahen në sistemin e bazës së të dhënave të maturës shtetërore për një afat të pacaktuar. Institucioni juaj ka rregulla të hollësishme (akte dhe rregullore të ndryshme), me qëllim të organizimit të provimeve kombëtare në sistemin parauniversitar, pranimeve në universitete, organizimit të provimeve të shtetit për profesionet e rregulluara, në të cilat nuk janë parashikuar rregulla për mbledhjen, përpunimin, ruajtjen, sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale.

Institucioni juaj nuk ka hartuar një rregullore të veçantë lidhur me mbledhjen, përpunimin dhe ruajtjen e të dhënave personale, ku të përcaktohet edhe koha e mbajtjes së të dhënave personale të përpunuara në sistemin online të maturës shtetërore dhe provimeve të shtetit për profesionet e rregulluara. Bazuar në kërkesat e neneve 5, 27, 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, ju lind detyrimi të hartoni rregullore të veçantë lidhur me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen, sigurinë dhe konfidencialitetin e të dhënave personale, ku të përfshihen dhe rregulla lidhur me kohën e mbajtjes së të dhënave personale të përpunuara në sistemin online të maturës shtetërore dhe provimeve të shtetit për profesionet e rregulluara. Hartimi i rregullave është një siguri më shumë për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të subjekteve të të dhënave, gjatë përpunimit të të dhënave personale që kryeni ju si kontrollues.

Informimi në kohën e duhur dhe sa më i saktë i subjekteve të të dhënave personale nga Institucioni juaj në drejtim të respektimit të privatësisë dhe përpunimit në respekt të ligjit i të

dhënave personale i parashikuar në nenin 18 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar, nuk është realizuar. Informacioni duhet të jepet i saktë dhe sa më shpejtë që të jetë e mundur dhe një mënyrë shumë efektive është informimi i subjekteve të të dhënave personale në faqet zyrtare në internet *Portali Qeveritar (www.e-albania.al)* dhe *Portali "Matura Online" (www.matura.akp.gov.al)*, në një rubrikë të veçantë të emëruar "*politikat e privatësisë*" (*paketë rregullash*), me qëllim informimin e subjekteve të të dhënave personale mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave personale, masat e sigurisë, ruajtjen e konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë.

Mbledhja, përpunimi dhe ruajtja e të dhënave personale përmes përdorimit të faqeve tuaja të internetit duhet të kryhen sipas parimit të respektimit dhe garantimit të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut dhe në veçanti të drejtës së ruajtjes së jetës private.

Institucioni juaj në zbatim nenit 21 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, ka plotësuar detyrimin ligjor për të njoftuar pranë Autoritetit të Komisionerit për përpunimin e të dhënave personale që ai kryen, por nuk ka deklaruar përpunimin e të dhënës biometrike "*gjurma e gishtit*" për subjektet e të dhënave personale që japin provimin e shtetit për profesionet e rregulluara, me qëllim verifikimin e tyre.

Të dhënat biometrike (*si shenjat e gishtave, irisi, retina, tiparet e fytyrës, etj*) ofrojnë burime unike dhe i atribuohen vetëm një individit dhe si karakteristika me anë të së cilave identifikohet ose të paktën është i identifikueshëm një individ, ato padyshim përbëjnë të dhëna personale. Prandaj, çdo mbledhje, ruajtje, ndarje, dërgim ose shkatërrim i këtyre të dhënave është përpunim i të dhënave personale, prandaj është tepër e rëndësishme të respektohen parimet për përpunimin e të dhënave biometrike. Institucioni juaj që qëllimi i përpunimit të të dhënave personale të jetë i ligjshëm e i drejtë sipas dispozitave të përcaktuara në ligjin nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar.

Njoftimi pranë Autoritetit të Komisionerit për përpunimin e të dhënave biometrike "*gjurma e gishtit*", duhej të bëhej para se ju si kontrollues të fillonit këtë përpunim. Në zbatim të nenit 21 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*" i ndryshuar, Institucionit tuaj i lind detyrimi të njoftojë pranë zyrës së këtij Autoriteti për përpunimin e të dhënave biometrike "*gjurma e gishtit*", duke kërkuar njëkohësisht nga ky Autoritet që sipas nenit 31/1/dh të këtij ligji të shqyrtojë kërkesën tuaj për marrjen e miratimit paraprak (*Autorizimit*) për përpunimin e të dhënave biometrike "*gjurma e gishtit*" dhe vetëm pas pajisjes me këto Autorizim nga Autoriteti i Komisionerit, ju mund të filloni përpunimin e të dhënave biometrike.

"*Agjencia Kombëtare e Provimeve*" mbledh, përpunon dhe ruan të dhëna personale (*imazhe*) nëpërmjet përdorimit të sistemit të "*video-survejimit*" në ambientet e sallave të provimit të administruara nga AKP, me qëllim mbikëqyrjen e procesit të provimit me qëllim shmangien e komunikimit të kandidatëve dhe sigurimin e transparencës. Institucioni juaj nuk ka përcaktuar rregulla të shkruara, për përdorimin e këtij sistemi, nuk ka vendosur tabela informuese për informimin e subjekteve të të dhënave për përdorimin e sistemit të "*video survejimit*" dhe të dhënat e mbledhura nga përdorimi i sistemit të "*video survejimit*" mbahen për një afat më shumë se dy muaj.

Përdorimi në këtë mënyrë i sistemit të "*video survejimit*" në këto ambiente është në kundërshtim me ligjin nr. 9887 datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 05/03/2010 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale "*Përpunimi i të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera*" i ndryshuar, prandaj nga ana juaj duhet të hartohet rregullore e veçantë për

përdorimin e sistemit të "video survejimit", duhet të vendosen në vende të dukshme tabela për informimin e subjekteve të të dhënave personale për përdorimin e sistemit të "video survejimit", si dhe të respektohet afati 2 mujor i mbajtjes të të dhënave personale të mbledhura nga përdorimi i këtij sistemi.

Në kontratat e lidhura nga institucioni juaj me kompanitë që mirëmbajnë sistemet nuk keni përfshirë rregulla mbi të drejtat dhe detyrimet që mbartin palët kontraktuese për garantimin e përdorimit të ligjshëm të sigurt dhe konfidencial të të dhënave personale, duke mos respektuar në këtë mënyrë nenin 20 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, si dhe Udhëzimin nr. 19 datë 03/08/2012 "Rregullimin e marrëdhënieve mes kontrolluesit dhe përpunuesit në rastet e përpunimit të të dhënave dhe përdorimin e një kontrate tip në rastet e këtij delegimi" të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Përcaktimi në kontratë i detyrimeve për përdorimin e ligjshëm dhe të sigurisë të të dhënave personale është detyrë parësore e institucioni tuaj si kontrollues i të dhënave personale. Ligjshmëria, siguria dhe konfidencialiteti për përdorimin e të dhënave personale të parashikuara në ligjin nr. 9887 datë 10.3.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar dhe akteve të Komisionerit, duhet të jetë gjithmonë nën vëzhgim dhe kontroll nga ana juaj, prandaj duhet që të bëhen ndryshimet e duhura në këto kontrata, ku të pasqyrohen detyrimet e palëve lidhur me mbrojtjen dhe konfidencialitetin e të dhënave personale.

Sa më sipër:

Në zbatim të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, si dhe nenet 107-109 të K. Pr. Administrative :

REKOMANDOJ

1. Në zbatim të neneve 21 dhe 31/1/dh të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar,

Të behet njoftimi pranë Autoritetit të Komisionerit për përpunimin të dhënave biometrike "gjurma e gishtit", të paraqitet kërkesa për marrjen e miratimit paraprak (Autorizimit) për përpunimin e të dhënave biometrike "gjurma e gishtit" nga Autoriteti i Komisionerit, si dhe të pezullohet mbledhja e mëtejshme e tyre deri në marrjen e miratimit paraprak (Autorizimit) të Komisionerit. Informacione të rëndësishme lidhur me përpunimin e të dhënave biometrike mund të gjeni në faqen zyrtare të Komisionerit www.kmdp.al, si dhe ofrojmë asistencën tonë.

2. Në zbatim të nenit 18 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar,

Në faqet zyrtare në internet Portalit Qeveritar (www.e-albania.al) dhe Portalit "Matura Online" (www.matura.akp.gov.al), të publikohen në një rubrikë të veçantë "politikat e privatësisë" (paketë rregullash), me qëllim informimin e subjekteve të të dhënave personale, si dhe të përfshihen kushtet e kriteret që reflektojnë parimet e përpunimit të ligjshëm dhe të drejtë të të dhënave personale. Disa nga këto parime do t'i gjeni në Opinionin "Mbi Mbrojtjen e të Dhënave Personale në Faqen e Internetit të Kontrolluesve Publik dhe Privat" publikuar në faqen zyrtare të KMDP-së www.kmdp.al.

3. Në zbatim të nenit 20 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar,

Në të gjitha kontratat me kompanitë që mirëmbajnë sistemet të përfshihen rregulla mbi të drejtat dhe detyrimet që mbartin palët kontraktuese për garantimin e përdorimit të ligjshëm të sigurt dhe konfidencial të të dhënave personale.

4. Në zbatim të Udhëzimit nr. 3 datë 05.03.2010 të Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale "Përpunimi i të dhënave personale me sistemin e video survejimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera" i ndryshuar,

Në vende të dukshme në ambientet e survejuara me kamera, të vendosen tabela informuese lidhur me përdorimin e sistemit të "video survejimit". Të dhënat e mbledhura nga përdorimi i sistemit të "video survejimit" të mbahen për një afat deri në dy muaj. Të hartohet rregullore lidhur me qëllimin, masat e sigurisë dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave personale nga përdorimi i sistemit të "video survejimit". Informacione të rëndësishme lidhur me "video survejimin" mund të gjeni në faqen zyrtare të Komisionerit www.kmdp.al, si dhe ofrojmë asistencën tonë.

5. Në zbatim të neneve 5, 27 dhe 28 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar,

Të hartohet rregullore për mbledhjen, mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen, sigurinë si dhe konfidencialitetin e të dhënave personale si dhe të caktohet koha e mbajtjes së të dhënave personale të përpunuara në sistemin online të maturës shtetërore dhe provimeve të shtetit për profesionet e rregulluara. Rregulloren tip mund ta gjeni në faqen zyrtare të Komisionerit www.kmdp.al, si dhe ofrojmë asistencën tonë.

6. Kryerja e këtyre detyrimeve të rëndësishme të realizohet brenda një afati kohor prej 45 (dyzet e pesë) ditësh, nga momenti i marrjes dijeni të këtij Rekomandimi.

7. Për plotësimin e këtyre detyrimeve të njoftohet me shkrim pranë Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

8. Me kalimin e këtij afati në rast mospërbushje të këtyre detyrimeve, Komisioneri vepron sipas nenit 30, pika 2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale" i ndryshuar, sipas të cilit.. "Komisioneri në rast shkeljesh serioze të përsëritura ose të qëllimshme të ligjit nga një kontrollues ose përpunues, veçanërisht në rastet e përsëritura të rekomandimeve të tij, vepron sipas nenit 39 të këtij ligji dhe e denoncon publikisht ose e raporton çështjen në Kuvend dhe në Këshillin e Ministrave".

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

